



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
UNIVERSITETI I TIRANËS  
FAKULTETI I HISTORISË DHE I FILOLOGJISË  
DEPARTAMENTI I HISTORISË

Programi: **Master**

Drejtimi: **Histori**

**Lënda: HISTORI SOCIALE**

<i>Pedagogu:</i>	Dr. Gentiana Kera
<i>Ngarkesa:</i>	7 ETCS (15 javë: 3 leksione dhe 1 seminar në javë)
<i>Lloji i lëndës:</i>	e detyrueshme
<i>Viti/semestri:</i>	I/II

**Përshkrimi:** Lindja e historisë sociale lidhet me rritjen e ndërveprimit të historisë me disiplina të tjera si antropologjia, psikologjia, sociologjia dhe shkencat politike. Historia sociale përfaqëson zhvendosjen e interesit nga ngjarjet politike tek strukturat social-ekonomike, dhe një ndryshim të metodave historike nga ato narrative (përshkruese) tek metodat sasiore dhe modelet ndërdisiplinore të interpretimit. Zgjerimi i fokusit nga historia e elitave politike tek grupe më të gjera social-politike ka nxitur gjithashtu edhe studime krahasuese të shoqërive në nivele mikro dhe makro.

Synimi i këtij cikli leksionesh është që të njohë studentët me zhvillimin e historisë sociale si një disiplinë e historisë, si dhe shkollat dhe qasjet kryesore historiografike, si historia e jetës së përditshme apo mikrohistoria. Në këtë cikël leksionesh do të trajtohen tema të rëndësishme të historisë sociale si zhvillimet demografike, urbanizimi, shteti i mirëqënies sociale, lidhja mes politikës dhe shoqërisë në Europë gjatë shek.XX.

**Temat e leksioneve:**

1. Hyrje në Historinë sociale/ Burimet dhe metodat e Historisë sociale
2. Zhvillimi i historisë sociale në Gjermani- Historia e jetës së përditshme
3. Zhvillimi i Historisë sociale në Francë
4. Zhvillimi i historisë sociale në Itali- Mikrohistoria
5. Bazat demografike të zhvillimit ekonomik dhe social në Europën e shek.XX (Lindshmëria dhe vdekshmëria)

6. Bazat demografike të zhvillimit ekonomik dhe social në Europën e shek.XX (Migracioni)
7. Martesa dhe familja, ndryshimet në strukturën familjare në Europë gjatë shek.XX, divorci dhe pluralizimi i formave të familjes.
8. Politika dhe shoqëria. Lidhja e sjelljes politike me faktorët ekonomikë dhe socialë
9. Bazat e sjelljes politike. Ndasitë kryesore në shoqërinë bashkëkohore europiane
10. Pjesmarrja në vendim-marrjen politike- zgjerimi i të drejtës së votës
11. Shteti i mirëqënies sociale, fillimet e shtetit të mirëqënies sociale në Europë, sistemet e mirëqënies sociale.
12. Puna, koha e lirë dhe konsumi. Evolucioni i standartit të jetesës, epoka e konsumit masiv, cilësia e jetesës në shek.XX, rrjedhojat mjedisore dhe sociale të rritjes ekonomike.
13. Urbanizimi në Europë gjatë shek.XX
14. Arsimi, feja dhe kultura, universitetet dhe shoqëria.
15. Interpretime të historisë sociale të Europës në shek.XX.

#### **Forma e kontrollit dhe vlerësimit**

- Detyrim frekuentimi në: 70% të seminareve	
- Angazhimi në seminare:	10% e notës
- Testi I: në javën e 6-të	10% e notës
- Testi II: në javën e 10-të	10% e notës
- Detyra e kursit ose ese: rreth 5 faqe format A4, TNR, 12, hapësira 1.5):	20% e notës
- Kontrolli përfundimtar: provim me shkrim	50% e notës
- Gjithsej:	100%

#### **Literatura e detyrueshme për studentin:**

Marc Bloch (2003), Apologji për historinë, Tiranë.

Dahrendorf, Ralf (2009), Konflikti shoqëror modern, Tiranë.

Filo, Llambro (2008), Sistemet Politike Bashkëkohore (Institucionet, Historia, Zhvillimet), Tiranë.

Filo, Llambro Filo (2007), Historia e Shtetit të Mirëqënies Sociale, Tiranë

Ginzburg, Carlo (1998), Djathi dhe krimbat. Bota e një mullisi të shek.XVI, Tiranë

Heywood, Andrew (2008), Politika, Tiranë.

Hobsbawm, Eric (1997), Epoka e ekstremeve, i rrëmbyeri shekull i njëzetë 1914 – 1991, Tiranë.

**Literatura plotësuese:**

Kaelble, Hartmut (ed) (2004), The European Way. European Societies in the 19th and 20th Centuries.

Kaelble, Hartmut (2003), Social History in Europe, Journal of Social History, 37 (1), fq. 29-35.

Kertzer, David I & Barbagli, Marzio: Family Life in the Twentieth Century. The History of the European Family, vol. 3.

Tomka, Bela (2013), A social history of twentieth-century Europe.

**MIRATOI**

**Përgjegjësi i Departamentit**

**Prof.As.Dr. Eva Hyskaj**